**KËRKESË**
**Nr. 207/10, datë 6.9.2024**

**PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Plotësimi, rakordimi dhe vazhdimi i punimeve Sheshi Shqiponja–Lumi i Tiranës, loti I dhe QMT"'.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vënë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit "truall", bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", dhe vendimin nr. 138, datë 23.2.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", sipas tabelës bashkëlidhur.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është **605,648.60** (gjashtëqind e pesë mijë e gjashtëqind e dyzet e tetë pikë gjashtë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
**Kastriot Gurra**

**LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT**

**"PLOTËSIMI, RAKORDIMI DHE VAZHDIMI I PUNIMEVE 'SHESHI SHQIPONJA'–LUMI I TIRANËS, LOTI I DHE QMT"**

| Nr. | Emri | Atësia | Mbiemri | Të dhënat e pasurisë | | | | Tokë "truall" | | | Objekt "banimi" | | | Vlera totale (lekë) | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Zona kadastrale | Numri i pasurisë | Sip. totale $m^2$ | Lloji i pasurisë | Sipërfaqja e shpr. ($m^2$) | Çmimi (lek/$m^2$) | Vlera lekë | Sipërfaqja e shpr. ($m^2$) | Çmimi $m^2$ | Vlera lekë | | |
| 1 | Alida "Kontakt" sh.p.k. | Haki | Maçi | 8310 | 12/309 | 536.00 | Truall | 19.4 | 31,219.00 | 605,648.60 | | | 0.00 | 605,648.60 | Seksioni E: Me VKM-në nr. 463, datë 10.6.2020, pezullohen transaksionet deri në hedhjen e gjurmës në hartën kadastrale dhe kalimin e pronësisë në favor të shtetit, sipas VKM-së nr. 463, datë 10.6.2020, pasuria nr. 12/139, ZK 8310 është shpronësuar për sip. 862.6 $m^2$, nga 882 $m^2$ në total. Sipas shkresës së ASHK-së nr. 2886/2 prot., datë 7.5.2024, për këtë pasuri rezultojnë të pa shpronësuar 19.4 $m^2$ truall në pronësi të Alida Haki Maçi dhe "Kontakt" sh.p.k. |
| 2 | Shtet | | | 8310 | 12/282 | 178.00 | Truall | 70.2 | | 0.00 | | | 0.00 | 0.00 | Seksioni E: Kjo pasuri është okupuar nga Haxhi Balla , Shaqir Shutina, Emilian Muco, Andrea Gaqo Furxhi, Micello Bacu, Vasil Shallo.<br>Seksioni D: Haxhi Balla , Shaqir Shutina, Emilian Muco, Andrea Gaqo Furxhi, Micello Bacu, Vasil Shallo janë bashkëpronarë të pasurive me nr. 12/132-nd., vol. 14, f. 122; 12/133-nd., vol. 14, f. 123; 12/134-nd. Vol. 14, f. 124 12/135-nd., vol. 14, f. 125, që ndodhet mbi truallin 12/282, vol. 104, f. 15. |
| Totali | | | | | | | | 89.6 | | 605,648.60 | 0.00 | | 0.00 | 605,648.60 | |